



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2021:122873

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05647864

C.nr.403/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtaren Lirika Sylaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A.G, B.N, H.O, S.B, A.B dhe F.SH të gjithë nga Komuna e Istogut, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Diamant Zekaj avokat në Prishtinë, me adresë të zyrës në sheshin “Nëna Tereza” A-22, hyrja 2, nr.5, kundër të paditurës Komuna e Istogut - Drejtoria Komunale e Arsimit, sipas objektit të kontestit kompensim i diferencës në pagë mbi bazën e kualifikimit, jashtë seancës gjyqësore, me datë 02.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

për shkak të pa dëgjueshmërisë – mosbindjes

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve A.G, B.N, H.O, S.B, A.B dhe F.SH që të gjithë nga Komuna e Istogut, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Istogut - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve t’iu kompensojnë shumatat si në vijim:

- paditëses A.G në emër të kompensimit të diferencës së pagave të pa paguara mbi bazën e kualifikimit në punë, për periudhën kohore nga muaji Qershor 2018 e deri me datën 20.11.2022, (54 muaj x 55.35 €), për kualifikimin Bachelor në vlerë të 27% të pagës bazë, *t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 2,988.90 Euro.*
- Paditësit H.O, në emër të kompensimit të diferencës së pagave të pa paguara mbi bazën e kualifikimit në punë për periudhën kohore nga muaji Qershor 2018 e deri me datën 20.11.2022, (27 muaj x 55.35 €), për kualifikimin Bachelor në vlerë të 27% të pagës bazë, *t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,494.45 Euro.*
- Paditësit S.B, në emër të kompensimit të diferencës së pagave të pa paguara mbi bazën e kualifikimit në punë për periudhën kohore nga muaji Qershor 2018 e deri me datën 20.11.2022, (27 muaj x 55.35 €), për kualifikimin Bachelor në vlerë të 27% të pagës bazë, *t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,494.45 Euro*
- paditëses A.B, në emër të kompensimit të diferencës së pagave të pa paguara mbi bazën e kualifikimit në punë për periudhën kohore nga muaji Qershor 2018 e deri me datën 20.11.2022, (54 muaj x 55.35 €), për kualifikimin Bachelor në vlerë të 27% të pagës bazë, *t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 2,988.90 Euro.*

- paditëses F.Sh., në emër të kompensimit të diferencës së pagave të pa paguara mbi bazën e kualifikimit në punë për periudhën kohore nga muaji Qershor 2018 e deri me datën 20.11.2022, (54 muaj x 55.35 €), për kualifikimin Bachelor në vlerë të 27% të pagës bazë, *t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 2,988.90 Euro*, të gjitha këto së bashku me kamatën ligjore prej 8% në vit, e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë, gjegjësisht data 15.06.2021, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësit Besnik Nimanaj, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Istogut - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit në emër të kompensimit të diferencës së pagave të pa paguara mbi bazën e kualifikimit në punë për periudhën kohore nga muaji Qershor 2018 e deri me datën 20.11.2022 (54 muaj x 60 €), për kualifikimin Bachelor në vlerë të 27% të pagës bazë, *t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 3,240 Euro*, me kamatën ligjore prej 8% në vit, e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë, gjegjësisht data 15.06.2021, e deri në pagesën definitive në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit Besnik Nimanaj përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë shumën prej 1,294.38 Euro, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit.

IV. OBLIGOHET e paditura Komuna e Istogut - Drejtoria Komunale e Arsimit, t'ia paguaj paditësve shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 645 €, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit, përmes përfaqësuesit të autorizuar kanë paraqitur padi me datë 15.06.2021, të precizuar më vonë me parashtrësën e datës 17.10.2023, kundër paditurës Komuna e Istogut – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensim të kualifikimit pa shpëputje nga puna.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi me datë 04.05.2022 të cilin e paditura e ka pranuar me datë 16.05.2022. Të njëjtës i është dërguar edhe parashtrësja për precizim të kërkesëpadisë të cilën e paditura e ka pranuar me datë 11.03.2024 (*këto të konfirmuara përmes fletë kthesave, të cilat gjendet në shkresat e lëndës*).

Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht, për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes - pa dëgjueshmërisë.

E paditura, pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ka gjetur së në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në

fjalë nga neni 150 paragrafi 1 pikat a), b) dhe (c) të LPK-së, nëse të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadiës del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Themelësia e kërkesëpadiës për paditësen A.G del nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, konkretisht nga: kontrata me numër 903/13 e datës 26.09.2013 e lidhur në mes të paditurës dhe paditëses nga e cila vërtetohet se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura si mësimdhënëse e gjuhës angleze në Sh.f.m.u “Hysni Zajmi” në fshatin Vrellë, diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Edukimit, nr.855, për njohjen e titullit “Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze”, licenca me numër 100023023 e lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nga e cila vërtetohet se paditësja ka fituar licencën e mësimdhënësës së karrierës si dhe lista pagave nga e cila vërtetohet paga bazë e paditëses në vlerë prej 421 Euro. Për paditësin B.N themelësia e kërkesëpadiës del nga: kontrata me numër 05.Nr.168/17 e datës 04.05.2017 e lidhur në mes të paditurës dhe paditësit nga e cila vërtetohet se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura si drejtor i shkollës “Mehmet Akif” në Shushicë, diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Edukimit, nr.39, për njohjen e titullit “Profesor i mësimit klasor”, licenca me numër 100017840 e lëshuar nga MASHT si dhe lista pagave nga e cila vërtetohet paga bazë e paditësit në vlerë prej 476.25 Euro. Për paditësin H.O themelësia e kërkesëpadiës del nga: kontrata me numër 348/18 e datës 05.09.2018 e lidhur në mes të paditurës dhe paditësit nga e cila vërtetohet se paditësi ishte në marrëdhënie pune te e paditura si mësimdhënësi i gjuhës dhe letërsisë shqipe 10 orë në sh.f.m.u “Avni Rrustemi” në fshatin Zallq si dhe 10 orë në sh.f.m.u “Trepça” në Banjë, vendimi mbi pensionimin nga i cili vërtetohet paditësi e ka arritur moshën e pensionimit me datën 18.10.2020, diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Edukimit, me nr. 2269, për njohjen e titullit “Profesor” si dhe lista pagave nga e cila vërtetohet paga bazë e paditësit në vlerë prej 421 Euro. Për paditësin Sahit Balaj themelësia e kërkesëpadiës del nga: kontrata me numër 128/19 e datës 20.03.2019 e lidhur në mes të paditurës dhe paditësit nga e cila vërtetohet se paditësi ishte në marrëdhënie pune te e paditura si mësimdhënësi i historisë – gjeografisë në sh.f.m.u “Avni Rrustemi” në fshatin Zallq, vendimi mbi pensionimin nga i cili vërtetohet paditësi e ka arritur moshën e pensionimit me datën 20.03.2020, diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Edukimit, me nr. 2264, për njohjen e titullit “arsimtar i historisë dhe gjeografisë” si dhe lista pagave nga e cila vërtetohet paga bazë e paditësit në vlerë prej 421 Euro. Për paditësen A.B del nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, konkretisht nga kontrata me numër 654/19 e datës 17.09.2019 e lidhur në mes të paditurës dhe paditëses nga e cila vërtetohet se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura si mësimdhënëse e ciklit fillorë në Sh.f.m.u “Avni Rrustemi” paralelja e ndarë në Rakosh, diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Edukimit, nr.4247, për njohjen e titullit “Bachelor i programit fillor”, licenca me numër 1026853 e lëshuar nga MASHT si dhe lista pagave nga e cila vërtetohet paga bazë e paditëses në vlerë prej 421 Euro. Për paditësen F.Sh themelësia e kërkesëpadiës doli nga provat: kontrata me numër 655/19 e datës 17.09.2019 e lidhur në mes të paditurës dhe paditëses nga e cila vërtetohet se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura si mësimdhënëse e ciklit fillorë në Sh.f.m.u “Avni Rrustemi” paralelja e ndarë në Rakosh, diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Edukimit, nr. 4006, për njohjen e titullit “Bachelor i programit fillor” licenca me numër 1027450 e lëshuar nga MASHT si dhe lista pagave nga e cila vërtetohet paga bazë e paditëses në vlerë prej 421 Euro.

Në funksion të vlerësimit të bazës ligjore të mbështetjes së kërkesëpadiës, Gjykata iu referua Vendimit Nr.01/33, të datës 29.08.2008, të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ku në

pikën 3 të këtij Vendimi shprehimisht përcaktohet që: “*Ngritja e pagave për mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në nivelin fillor dhe atë të mesëm bëhet në bazë të kriterëve të licencimit, si: përgatitja profesionale (kualifikimi) dhe përvoja e punës*”. Pika 4 e të njëjtit vendim përcakton që: “*Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional të pajisur: Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagesës bazë prej 27%; Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoratë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%*”. Në kuader të zbatimit të këtij vendimi, së fundmi gjykata iu referua edhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, GJ.A-Su.A, 214/2023, të dt.09.10.2023, specifikisht pikës I të këtij Mendimi, ku përcaktohet: “*Për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008*”.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim që paditësve t’iu paguajë kompensimin mbi bazën e kualifikimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), ku është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe bashkëpunëtorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, *me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %*.

Mbi këtë bazë, gjykata i ka aprovuar shumat përkatëse duke e bërë përllogaritjen e vlerës prej 27% të pagës bazë për secilin paditës e duke e bërë zbritjen e shumës në vlerë prej 58.32 Euro për paditësit e tjerë ndërsa për paditësin B.N shumën prej 68.58 Euro, shumë kjo e kompensuar në kuadër të pagës mujore të paditësve (*fakt i provuar nga listat e pagave*). Shuma e mbetur, e ajo në vlerë prej 55.35 për paditësit e tjerë ndërsa në raport me paditësin B.N shuma prej 60 Euro është shumëzuar me muajt e precizuar për kompensim, gjegjësisht 45 dhe 27 muaj. Bazuar në këto konstatime, u vendos si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke marrë në konsideratë edhe dispozitën nga neni 2 par.1 të LPK-së, e cila përcakton: “*Në procedurë kontestimore gjykata vendosë brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse.*”

Në anën tjetër, sa i përket pjesës refuzuese, gjykata i’u referua listes së pagave për paditësin B.N nga e cila është konstatuar se paga bazë e paditësit është 476.25 Euro e jo shuma e pretenduar me padi, e që sipas përllogaritjeve të gjykatës $476.25 \times 27\% = 128.58 - 68.58 = 60 \times 54$ muaj = e që në total arrin shumën prej 3, 240 Euro. Andaj mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit sikurse në pikën nën II të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën III të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata po ashtu aprovoj shumën përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashtrimit të padisë, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palëve paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të

procedurës u bazua në nr. tarifor 6 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës ashtu që lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet 624 euro për përpilim të padisë dhe 21 euro për pagesën e taksës gjyqësore.

Mbi bazën e të lartcekurave, në mbështetje të nenit 150 par.1 pika a, b, dhe c të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA ISTOG,
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni për Çështje Civile
C.nr.403/21 data 02.05.2024

Gj y q t a r j a
Lirika Sylaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, në kuptim të dispozitës nga neni 477 të LPK-së është e lejuar ankesa, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.